



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 3, al. 1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000, dhe nenit 19, al.1, pika “b” të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 15.08.2005 merr

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR
NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË QENDRËS KARDIOKIRURGJIKE NË
PRISHTINË NR. 01.353-1118 TË DT. 19.06.2003

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin objektit të Qendrës Kardiokirurgjike në Prishtinë, nr.01-353-1118 të dt. 19.06.2003

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 2805/1, Zona kadastrale Prishtinë, në sipërfaqe përafërsisht prej 1.5 ha.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në Planin e ardhshëm rregullativ të Qendrës Klinike Universitare të Prishtinës.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit për lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejeimin e ndërtimit të objektit investiv, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, i Urbanizmit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës do të kryejnë veprime nga përgjegjësitë e tyre, të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ditën e miratimit të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Qendrës Kardiokirurgjike në Prishtinë, nr. 01-353-1118, të dt. 19.06.2003.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.NR. 353-19304 DT. 18.08.2005

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri